



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 pika d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, 28 qershor), neni 5, neni 6 paragrafi 1.1 dhe neni 14 pika 3, i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pasurisë së Paluajtshme Komunale, (Ligji nr. 06/L-092 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 03.04.2019), në bazë të nenit 4 dhe neni 8 i Rregullores së QRK-së 09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 32 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr. 06 - 103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 29.02.2024, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PATUNDSHMËRISË KOMUNALE

Neni I

1.1 Jepet në shfrytëzim afatgjatë Parcela Kadastrale P-70604038-00244-4 e cila gjendet në ZK. Kadastrale Shajne me sipërfaqe 12500 m².

Neni II

Afatati i shfrytëzimit të pronës së lartëcekur është 35 (tridhjetë e pesë) vite nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

Neni III

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës, gjenerimi i të ardhurave, pasi që në zonën kadastrale në Shajne tek vendi i quajtur Dubrava-Mejdan si dhe e gjithë sipërfaqja dhe parcelat janë të përshtatshme për kryerjen e veprimtarive ekonomike, afariste. Me qëllim të krijimit të kushteve për përshtatjen e zonës së sipërpërmendur me një aktivitet më të lehtë ekonomik dhe krijimin e kushteve për investime, është asfaltuar rruga, është ndërtuar rrjeti elektrik dhe kushte të tjera të nevojshme. Pas një analize me persona kompetentë në Komunën e Dragashit, është e nevojshme të jepet për shfrytëzim afatgjatë parcela 70604038-00244-4 ZK Shajne, Komuna Dragash, në vendin e quajtur Dubrava-Mejdan, me një sipërfaqe prej 12500m², e cila në regjistrin e pronës evidentohet në emër të Komunës së Dragashit 1/1. Kjo për faktin se është një sipërfaqe relativisht e madhe dhe plani për t'u dhënë për përdorim afatgjatë dhe të gjitha kushtet e tjera të përshkruara janë kyçe që investitorët potencialë të

investojnë kapitalin e tyre në këtë vend. Parcela i plotëson të gjitha kërkesat ligjore nga neni 4 i Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzimin dhe këmbimin të pronës së paluajtshme komunale.

Neni IV

Procedura për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për dhënien afatgjatë në shfrytëzim do të jepet nëpërmjet shprehjes së interesit nga komisioni vlerësues, ku do të caktohen kushtet për aplikim, çmimi fillestar etj.

Neni V

Të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesit të ardhshëm të pronës së paluajtshme të Komunës do të caktohen në marrëveshjen e cila do të lidhet, duke pas parasysh legjislacionin në fuqi (ligjet financiare, tatimore etj.).

Neni VI

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Komisioni Vlerësues dhe sipas nevojës dhe autoriteti kompetent

Neni VII

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit.

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 060/01-4101/24-1

Dt. 29.02.2024



**Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj**

A Skeraj